



Ne bazë të nenit 14 dhe nenit 58 pika a), b), d), g) i), të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-40 dhe në përputhje me nenin 6, 7 dhe 8 të Ligjit nr.04/L-144 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtëshme të Komunës, dhe nenet 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18 të Kapitullit III të Rregullores së QRK-së Nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Palujtëshme të Komunës si dhe nenit 21 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.01.2016, bie këtë::

VENDIM

PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË (99) VITE TË TOKËS NDËRTIMORE KOMUNALE ME KONKURS PUBLIK

I.

Merret **VENDIMI** për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (99) vite të tokës ndërtimore në pronësinë komunale me konkurs publik, me qëllim të ndërtimit të lartë në qytetin e Deçanit, i cili përfshinë ngastrat në vijim: ngastra nr. **1072**, me sipërfaqe 3730 m², Komuna Kadastrale Deçan, me kulturë ndërtësë dhe oborr, 02006-0, Komuna Kadastrale Deçan, Zona e parë në Deçan.

II.

Në ngastrën e cekur më lartë me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, parashihet që të ndërtohen objekte të larta për banim dhe afarizëm, me qëllim të përfitimit publik.

III.

Me rastin e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite të ngastrës së cekur më lartë, marrësi i tokës në shfrytëzim duhet t'i përmbahet Planit Urbanistik.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi dhe për procedurat e dhënies në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite autorizohet Komisioni Komunal i formuar në Asamble, sipas të gjitha Ligjeve në fuqi.

V.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Asambleja komunale në Deçan.

VI.

Me nga një kopje të Vendimit do të paisen: Komisioni Komunal i formuar në Asamble dhe Arkivi Komunal.

01.Nr.I-5

Deçan, dt.29.01.2016

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

HYRESE-ULAZNA-INCHING	
REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA	
KOMUNA E DEÇANIT • OPSTINA DEÇANE • DEÇAN MUNICIPALITY	
Nga:	Nr. Prot: 3289
Od:	Sr. Prot:
From:	Prot. No.
Nr. i fletëve:	Data: 23.02.16
Sr. Stranica:	Datë:
No Pages: 01	
DECAN DEÇANE	



Kryesuesi i Kuvendit
Jashar Dobraj